



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 22

Tiranë – E hënë, 5 shkurt 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 46, datë 31.1.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 456, datë 29.6.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”..... 2475
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 31.1.2024	Për një ndryshim në vendimin nr. 786, datë 11.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e Varrezave të Dëshmorëve të Atdheut”..... 2476
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 31.1.2024	Për përcaktimin e procedurave, kushteve, kriterëve, afateve, vlefshmërisë dhe formateve për dhënien, shfuqizimin dhe pezullimin e autorizimeve për kryerjen e veprimtarisë së magazinimit, transferimit dhe asgjësimit të lëndëve plasëse për përdorim civil..... 2476
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 49, datë 31.1.2024	Për përcaktimin e kriterëve dhe të masës së përfitimit të pagesës së qirasë për strehim për punonjësit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore..... 2487
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 51, datë 31.1.2024	Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Inteligjencës Financiare..... 2487
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 52, datë 31.1.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 564, datë 31.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e veçantë të magistratit gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij”.... 2491
Urdhër i ministrit të Financave nr. 3, datë 26.1.2024	Për delegim kompetence..... 2491

Urdhër i ministrit të Turizmit
dhe Mjedisit dhe i ministrit
të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
nr. 15, datë 15.1.2024

Për miratimin e rregullores “Mbi funksionimin e Komisionit Vlerësues
të Certifikimit të Subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit,
procedurat e aplikimit, të vlerësimit paraprak dhe përfundimtar, si dhe
pezullimi dhe/ose shfuqizimi i ‘Certifikatës paraprake’ apo i
‘Certifikatës’”

2492

Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Eduart Aliaj.....

2503



VENDIM
Nr. 46, datë 31.1.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 456, DATË 29.6.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E KUSHTEVE PËR
VENDOSJEN E DETYRIMIT TË
SHËRBIMIT PUBLIK, QË DO TË
ZBATOHEN NDAJ TË LICENCUARVE
NË SEKTORIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË CILËT USHTROJNË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT,
TRANSMETIMIT, SHPËRNDARJES DHE
FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në tekstin “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të miratuar me vendimin nr. 456, datë 29.6.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nenin 3, të pjesës I, shtohen pikat 5 dhe 6, me këtë përmbajtje:

“5. Në këtë vendim, fjalët “instrument financiar” nënkuptojnë marrëveshje për faturimin reciprok të diferencës midis çmimit klerues për njësi kohore të tregut (të ditës në avancë ose tregun brenda së njëjtës ditë) për ditën e lëvrimit me çmimin e parashikuar në marrëveshjen e lidhur midis palëve, të cilat sigurojnë pjesëmarrësit ndaj luhatjeve të mundshme të çmimit të energjisë elektrike në treg.

6. Në këtë vendim, fjalët “treg likuid” nënkuptojnë tregun që përmbush kriteret për gatishmërinë e tij, bazuar në vlerësimin e bërë nga ERE-ja, sipas përcaktimeve të nenit 30, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e burimeve të rinovueshme.”.

2. Në nenin 5, të pjesës II, bëhen këto shtesa:

a) Në pikën 3, pas fjalëve “...të kryejë transaksione shitblerjeje energjie në tregun e lirë...”

shtohen “... përfshirë tregun e ditës në avancë ose tregun brenda së njëjtës ditë...”;

b) Në pikën 7 bëhen këto shtesa:

i. Pas fjalëve “...nga burimet e rinovueshme të energjisë në periodat pararendëse...” shtohen “...sipas parashikimeve të nenit 12, të këtyre kushteve,...”;

ii. Pas fjalëve “...me çmimin e blerjes së energjisë së prodhuesve me përparësi hidrike...” shtohen “...dhe më tej tregtohet në tregun e lirë ose të ditës në avancë ose tregun brenda së njëjtës ditë...”.

3. Në nenin 12, të pjesës II, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 3 bëhen këto shtesa:

i. Pas fjalëve “...krijimin e operatorit të energjisë së rinovueshme dhe krijimin e tregut...” shtohen “...likuid të energjisë elektrike...”;

ii. Në fund të kësaj pike shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Çmimi i blerjes së energjisë nga tepricat e burimeve të rinovueshme për furnizimin e klientëve të furnizuesit publik në treg të lirë, duke filluar nga 1 janari 2024 është çmimi i blerjes së energjisë së prodhuesve me përparësi hidrike, ndërsa çmimi i shitjes për njësi miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.”.

b) Në pikën 4, dy fjalitë e para ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Në rast të tepricave të krijuara nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, ato fillimisht do të tregtohen për nevoja të furnizimit të klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, ndërsa sasia e mbetur do të depozitohet te shoqëria publike e prodhimit, për t’u përdorur për nevoja të furnizimit të klientëve universalë. Sasitë rakordohen me bazë mujore dhe shkëmbehen gjatë vitit për mbulimin e humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe nevojave të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, bazuar në sasinë dhe programet e kërkuara nga furnizuesi i tregut të lirë, për të cilat është rënë dakord ndërmjet palëve.”.

c) Në pikën 5 bëhen këto shtesa:

i. Pas fjalëve “...ta sigurojë këtë energji në treg të parregulluar...” shtohen “..., kryesisht ose...”;

ii. Pas fjalëve “...të miratuar me vendim të Entit Rregullator të Energjisë...” shtohen “..., të cilat mund të përfshijnë edhe përdorimin e instrumenteve financiare.”.



4. Në nenin 12, të pjesës II, shtohet neni 12/1, “Mbulimi i humbjeve në transmetim”, me këtë përmbajtje:

“Neni 12/1

Mbulimi i humbjeve në transmetim

Operatori i Sistemit të Transmetimit siguron energjinë për mbulimin e humbjeve në tregun e parregulluar të ditës në avancë ose tregun brenda së njëjtës ditë apo nëpërmjet procedurave, sipas parashikimeve të nenit 62, ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të cilat mund të përfshijnë edhe përdorimin e instrumenteve financiare.”.

II. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 47, datë 31.1.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 786, DATË 11.12.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR NDËRTIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE RUAJTJEN E VARREZAVE TË DËSHMOREVE TË ATDHEUT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 109/2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5, e vendimit nr. 786, datë 11.12.2019, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, ministria përgjegjëse për kulturën, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë institucione përgjegjëse për projektimin dhe ndërtimin e Varrezave të reja të Dëshmorëve të Atdheut dhe rikonstruksionin e tyre. Projektimi, ndërtimi dhe

rikonstruksioni bëhen kundrejt fondeve buxhetore që do të akordohen, rast pas rasti.”.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 48, datë 31.1.2024

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, KUSHTEVE, KRITEREVE, AFATEVE, VLEFSHMËRISË DHE FORMATEVE PËR DHËNIEN, SHFUQIZIMIN DHE PEZULLIMIN E AUTORIZIMEVE PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SË MAGAZINIMIT, TRANSFERIMIT DHE ASGJËSIMIT TË LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 22, të ligjit nr. 74/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

OBJEKTI, STRUKTURA PËRGJEGJËSE, KUSHTET DHE KRITERET PËR PAJISJEN ME AUTORIZIM PËR MAGAZINIMIN, ASGJËSIMIN DHE TRANSFERIMIN E LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL

Neni 1
Objekti

Ky vendim përcakton procedurat, kushtet, kriteret, vlefshmërinë, afatet dhe formatet për dhënie, shfuqizimin dhe pezullimin e autorizimeve për kryerjen e veprimtarisë së magazinimit, transferimit dhe asgjësimit të lëndëve plasëse për përdorim civil.

Neni 2

Struktura përgjegjëse për dhënien e autorizimit për magazinimin, transferimin dhe asgjësimin

Struktura përgjegjëse për dhënien e autorizimit për kryerjen e veprimtarisë së magazinimit, transferimit dhe asgjësimit të lëndëve plasëse për përdorim civil është komisioni i ngritur për këtë qëllim në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 3

Kushtet dhe kriteret e pajisjes me autorizim për magazinimin e lëndëve plasëse

1. Operatori ekonomik që kërkon të pajiset me autorizim për kryerjen e veprimtarisë së magazinimit të lëndëve plasëse për përdorim civil plotëson kushtet e mëposhtme:

a) Të jetë i regjistruar si subjekt tregtar në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) Të ketë në pronësi apo në përdorim objektin për magazinim, sipas një kontrate qiraje ose nënqiraje apo huaje përdorimi të njësuar nga noteri;

c) Të ketë projektin për magazinën, si dhe vërtetimin për kolaudimin e objektit të lëshuar nga organi përgjegjës që mbulon çështjet e infrastrukturës dhe energjetikës;

ç) Të ketë kontraktuar një subjekt të shërbimit privat të sigurisë fizike për ruajtjen e magazinës;

d) Të sigurojë që ambienti i jashtëm dhe i brendshëm i magazinës të jetë i monitoruar me kamera, sipas kërkesave të ligjit për masat shtesë të sigurisë;

dh) Të ketë aktin teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

Neni 4

Kushtet dhe kriteret e pajisjes me autorizim për transferimin e lëndëve plasëse

1. Operatori ekonomik që kërkon të pajiset me autorizim për transferimin e lëndëve plasëse për përdorim civil plotëson kushtet e mëposhtme:

a) Të jetë i pajisur me licencën për import, eksport dhe prodhim të lëndëve plasëse për përdorim civil nga Ministria e Mbrojtjes, apo me autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse,

lëshuar nga ministria përgjegjëse për energjinë dhe çështjet minerare;

b) Të vërtetojë se personi që do të shoqërojë lëndën plasëse të jetë i pajisur me dëshminë e zjarrmëtarit, lëshuar nga organi përgjegjës që mbulon çështjet e infrastrukturës dhe energjetikës;

c) Të ketë në pronësi apo në përdorim objekt për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, të miratuar sipas këtij vendimi;

ç) Të vërtetojë se edhe operatori ekonomik që pret mallin të ketë në pronësi apo në përdorim objekt për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, të miratuar sipas këtij vendimi;

d) Të vërtetojë se drejtuesi i automjetit që kryen transportin në rastet e transferimit ndërkombëtar të jetë i pajisur me certifikatë “ADR”, sipas legjislacionit në fuqi për transportin e lëndëve të rrezikshme;

dh) Të vërtetojë se automjeti që kryen transportin ndërkombëtar të jetë i pajisur me certifikatë “ADR”, sipas legjislacionit në fuqi për transportin e lëndëve të rrezikshme dhe me GPS (sistem për lokalizim gjeografik) funksional për kontrollin dhe dokumentimin e itinerarit në subjektin që bën transferimin;

e) Të ketë vërtetimin dhe aktin e kontrollit nga shërbimi vendor i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin se automjeti që kryen transportin është i pajisur me shenjat konvencionale treguese për transport të lëndëve plasëse, si dhe fikse zjarri, jo më të vogla se 6 (gjashtë) kg dhe jo më pak se 2 (dy) copë;

ë) Të ketë të deklaruar origjinën e mallit.

2. Rastet kur transferimi i mallit kryhet nga transportuesit e huaj me mjetet e tyre të transportit, të pajisur me certifikatë “ADR” në vendet e origjinës, si dhe rastet e tranzitimit të këtyre mallrave nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë përjashtohen nga shkronja “ë”, e pikës 1, të këtij neni.

Neni 5

Kushtet dhe kriteret e pajisjes me autorizim për asgjësimin e lëndëve plasëse

1. Operatori ekonomik që kërkon të pajiset me autorizim për kryerjen e procedurës së asgjësimit të lëndëve plasëse për përdorim civil plotëson kushtet e mëposhtme:



a) Të ketë licencë për prodhim, import, eksport, tranzitim të lëndëve plasëse për përdorim civil, të lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes;

b) Të ketë autorizim për përdorimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, të lëshuar nga ministria përgjegjëse për energjinë dhe çështjet minerare;

c) Të ketë një marrëveshje me subjektet e licencuara nga Ministria e Mbrojtjes, të cilat ofrojnë edhe shërbimin e shkatërrimit apo çmilitarizimit të lëndëve plasëse;

ç) Të deklarojë sasinë, llojin, origjinën dhe arsyet e asgjësimit të lëndëve plasëse për përdorim civil.

KREU II

PROCEDURAT, AFATET, VLEFSHMËRITË DHE FORMATET PËR KËRKESËN DHE DHËNIEN E AUTORIZIMEVE PËR MAGAZINIMIN, TRANSFERIMIN DHE ASGJËSIMIN E LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL

Neni 6

Kërkesë për pajisjen me autorizim

1. Operatori ekonomik bën kërkesën për pajisje me autorizimin përkatës në portalin “e-Albania”.

2. Operatori ekonomik pajiset elektronikisht të “Hapësira ime” në portalin “e-Albania” me dokumentin e autorizimit, të lëshuar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik nga institucioni shërbim ofrues.

Neni 7

Formati për kërkesën për pajisjen me autorizim për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil

1. Format i kërkesës për t’u pajisur me autorizim për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil është sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, si dhe përmban:

- a) emrin e operatorit ekonomik;
- b) adresën e selisë së operatorit ekonomik;
- c) të dhënat për administratorin dhe punonjësit, të cilët do të kryejnë veprimtari me lëndët plasëse të magazinuar, që përfshijnë emër, mbiemër, numër identifikimi personal;
- ç) adresën e vendndodhjes së magazinës;

d) llojin e lëndëve plasëse që do të magazinohen, si dhe kapacitetin maksimal të magazinës;

dh) afatin e magazinimit të lëndëve plasëse, të përcaktuar nga organi përgjegjës që mbulon çështjet e industrisë dhe energjetikës.

2. Së bashku me kërkesën për lëshimin e autorizimit për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, operatori ekonomik ngarkon në portalin “e-Albania” edhe këto dokumente shoqëruese:

a) Ekstraktin e regjistrit tregtar për të dhënat e operatorit ekonomik, të nxjerrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

b) Fotokopjen e dokumentit të pronësisë të noterizuar, nëse është pronë e subjektit ose dokumentin që vërteton të drejtën e përdorimit, nëse objekti i magazinimit është në pronësi të një të treti;

c) Vërtetimin nga organi përgjegjës që mbulon çështjet e industrisë dhe energjetikës, që përcakton se objekti i plotëson kushtet për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, sipas përcaktimeve në rregulloren e teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë;

ç) Certifikatën e mbrojtjes nga zjarri, lëshuar nga Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit;

d) Kontratën me subjektin privat të sigurisë fizike dhe fotokopjen e autorizimit të mbajtjes së armës së zjarrit të punonjësit/punonjësve që do të ruajnë magazinën;

dh) Vetëdeklarimin “Për verifikimin e gjendjes gjyqësore” të administratorit të operatorit ekonomik;

e) Vërtetim nga gjykata që operatori ekonomik nuk është në proces gjyqësor dhe nga prokuroria që operatori ekonomik nuk është në procedim penal.

Neni 8

Formati për kërkesën për pajisjen me autorizim për transferimin e lëndëve plasëse për përdorim civil

1. Autorizimet për transferimin e lëndëve plasëse për përdorim civil janë 2 (dy) lloje:

a) Autorizim për çdo ngarkesë dhe çdo mjet që bën transportin e ngarkesës;

b) Autorizim për transferim të herëpashershëm me afat vlefshmërie deri në 1 (një) vit.



2. Formati i kërkesës për t'u pajisur me autorizim për transferimin e lëndëve plasëse për përdorim civil është sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, si dhe përmban:

- a) emrin e operatorit ekonomik;
- b) adresën e selisë së operatorit ekonomik;
- c) të dhënat për administratorin e operatorit ekonomik, që përfshijnë emër, mbiemër, numër identifikimi personal;
- ç) adresën e vendndodhjes së magazinës dalëse dhe të magazinës pritëse;
- d) llojin e lëndëve plasëse që do të transferohen;
- dh) deklarin e origjinës së mallit;
- e) të dhënat e automjetit që do të kryejë transferimin;
- ë) të dhënat e drejtuesit të mjetit, që përfshijnë emër, mbiemër, numër identifikimi;
- f) të dhënat e shoqëruesit të pajisur me dëshminë e zjarrmëtarit, që përfshijnë emër, mbiemër, numër identifikimi personal.

3. Së bashku me kërkesën për lëshimin e autorizimit për transferimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, operatori ekonomik ngarkon në portalin “*e-Albania*” edhe këto dokumente shoqëruese:

- a) Ekstraktin e regjistrit tregtar për të dhënat e operatorit ekonomik të nxjerrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
- b) Kopje të licencës për import, eksport, prodhim të lëndëve plasëse për përdorim civil, lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes;
- c) Kopje të autorizimit për përdorim të lëndëve plasëse për përdorim civil, të lëshuar nga ministria përgjegjëse për energjinë dhe çështjet minerare;
- ç) Fotokopjen e dëshmisë së zjarrmëtarit, lëshuar nga organi përgjegjës që mbulon çështjet e energjisë dhe minerare;
- d) Certifikatën “ADR” të drejtuesit të mjetit, të lëshuar sipas legjislacionit në fuqi për transportin e lëndëve të rrezikshme, në rastet e transferimit ndërkombëtar;
- dh) Certifikatën “ADR” të automjetit, të lëshuar sipas legjislacionit në fuqi për transportin e lëndëve të rrezikshme, në rastet e transferimit ndërkombëtar;
- e) Vërtetimin dhe aktin e kontrollit, lëshuar nga shërbimi vendor i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për sinjalistikën e automjetit që do të kryejë transferimin;
- ë) Deklaratën e origjinës së mallit.

4. Njoftimi i strukturës përgjegjëse për dhënien e autorizimit për transferimin e herëpashershëm bëhet brenda jo më pak se 24 (njëzet e katër) orë para kryerjes së transferimit të lëndëve plasëse për përdorim civil. Ky njoftim kryhet me *e-mail* në adresën e përcaktuar në autorizimin e lëshuar.

Neni 9

Formati për kërkesën për pajisjen me autorizim për asgjësimin e lëndëve plasëse për përdorim civil

1. Format i kërkesës për t'u pajisur me autorizim për asgjësimin e lëndëve plasëse për përdorim civil është sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, si dhe përmban:

- a) të dhënat për administratorin e operatorit ekonomik, që përfshijnë emër, mbiemër, numër identifikimi personal;
- b) vendin e kryerjes së procedurës së asgjësimit;
- c) sasinë dhe llojin e lëndës plasëse që asgjësohet;
- ç) datën dhe orën në të cilën do të kryhet procedura e asgjësimit.

2. Së bashku me kërkesën për lëshimin e autorizimit për asgjësimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, operatori ekonomik ngarkon në portalin “*e-Albania*” edhe këto dokumente shoqëruese:

- a) Ekstraktin e regjistrit tregtar të nxjerrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
- b) Marrëveshjen e lidhur me subjektet e licencuara nga Ministria e Mbrojtjes, të cilat ofrojnë edhe shërbimin e shkatërrimit apo çmilitarizimit të lëndëve plasëse;
- c) Deklaratën e origjinës së mallit;
- ç) Kopjen e licencës për prodhim, import, eksport apo përdorim të lëndëve plasëse për përdorim civil, të lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes.

Neni 10

Verifikimi i dokumenteve dhe formatet e autorizimit

1. Për pranimin, verifikimin dhe shqyrtimin e dokumenteve për autorizim, struktura përgjegjëse ndjek këtë procedurë:

- a) Verifikon dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik, si dhe plotëson formularët përkatës sipas rubrikave;



b) Verifikon besueshmërinë e kërkesit nëpërmjet autoritetit kompetent, brenda 5 (pesë) ditëve.

2. Formatet përkatëse të autorizimit janë sipas lidhjeve 4, 5 dhe 6, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

Neni 11

Afati për shqyrtimin e kërkesës

Afati për shqyrtimin e kërkesës për pajisjen me autorizim është:

- 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për pajisjen me autorizim për magazinim;
- 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për pajisjen me autorizim për transferim;
- 10 (dhjetë) ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për pajisjen me autorizim për asgjësim.

Neni 12

Procedura e shqyrtimit, dhënies së autorizimit apo mospranimit të kërkesës për pajisjen me autorizim

1. Struktura përgjegjëse për dhënien e autorizimit, në rastet kur konstaton mangësi në paraqitjen e kërkesës apo mungesë të dokumentacionit, njofton operatorin ekonomik për plotësimin e tyre.

2. Operatori ekonomik brenda 10 (dhjetë) ditëve duhet të plotësojë mangësitë e konstatuara. Në këtë rast, afati i shqyrtimit pezullohet deri në plotësimin e mangësive të kërkesës nga ana e operatorit ekonomik.

3. Kërkesa për pajisjen me autorizim nuk pranohet nëse operatori ekonomik nuk plotëson mangësitë e dokumentacionit brenda afatit 10-ditor.

4. Në rastet kur struktura përgjegjëse miraton kërkesën për dhënien e autorizimit, vendimi i miratimit të kërkesës i dërgohet operatorit ekonomik në të njëjtën adresë dhe me të njëjtat mjete që ka aplikuar. Formatet e autorizimit të lëshuar verifikohet në çdo rast kontrolli nga strukturat përgjegjëse të përcaktuara në ligjin për lëndët plasëse për përdorim civil.

5. Në rastet e transferimit të herëpashershëm, struktura përgjegjëse kthen përgjigje për dhënie të autorizimit, apo mospranim të kërkesës për autorizim për operatorin ekonomik me të njëjtat mjete, brenda të njëjtit afat që është bërë njoftimi nga operatori ekonomik.

6. Vendimi për mospranimin e kërkesës mund të ankimohet sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 13

Procedura e shfuqizimit dhe pezullimit të autorizimit

1. Përveç rasteve të përcaktuara në ligjin për lëndët plasëse për përdorim civil dhe në ligjin për licencat, autorizimet dhe lejet, autorizimi për magazinimin, transferimin e asgjësimit e lëndëve plasëse dhe licencat shfuqizohet edhe në rastet kur operatori ekonomik është në tejkallim, ka shkelur apo nuk përmbush më kriteret dhe kushtet e përcaktuara në kreun I, të këtij vendimi.

2. Struktura përgjegjëse, në rastet kur gjatë verifikimit të veprimtarisë së operatorit ekonomik gjen shkelje të kushteve të përcaktuara në autorizim, pezullon autorizimin deri në verifikimin e rrethanave.

3. Struktura përgjegjëse njofton për shfuqizimin e autorizimit me të njëjtat mënyra që është paraqitur kërkesa, duke nxjerrë një vendim të arsyetuar.

4. Vendimi për shfuqizimin apo pezullimin e autorizimit mund të ankimohet sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 14

Vlefshmëria e autorizimit

1. Afati i vlefshmërisë së autorizimit për magazinim është deri në 2 (dy) vjet për objekte magazinimi të përkohshme dhe deri në 6 (gjashtë) muaj për objekte magazinimi javore e ditore.

2. Afati i vlefshmërisë së autorizimit për transferim është 1-vjeçar për transferimet e herëpashershme.

3. Për transferimet për çdo ngarkesë dhe çdo mjet që bën transportin e ngarkesës afati i autorizimit për transferim është sa koha e kërkuar për transferimin.

4. Afati i autorizimit për asgjësim është i vlefshëm deri në 30 (tridhjetë) ditë.

5. Me mbarimin e afatit të vlefshmërisë së autorizimit, subjekti i interesuar për t'u pajisur sërish me këtë autorizim duhet të paraqesë kërkesën dhe dokumentacionin që provon përmbushjen e kushteve të autorizimit.



KREU III

Neni 15

Dispozita të fundit

1. Vendimi nr. 313, datë 15.4.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të dhënies së autorizimit për magazinimin, transferimin dhe asgjësimin e lëndëve plasëse për përdorim civil dhe lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë”, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Policia e Shtetit, Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

KËRKESË**Për pajisjen me autorizim për magazinim**

Drejtuar: Strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Brendshme _____

Unë _____ administrator i subjektit _____, i pajisur nga Ministria e Mbrojtjes/Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me licencë/autorizim nr. _____, “Për prodhim/përdorim të lëndëve plasëse për përdorim civil”, me adresë të selisë _____, me drejtues teknik _____, me adresë të _____, paraqes kërkesën, si më poshtë:

Ushtroj aktivitetin për prodhimin/import/eksport/përdorimin të lëndëve plasëse për përdorim civil në qytetin _____, i cili është në juridiksionin e Komisarariatit të Policisë _____.

Kam në pronësi/qira një magazinë në _____, në të cilën do të magazinoj lëndë plasëse të llojit _____, me sasi _____ për një afat _____.

Magazina plotëson kërkesat dhe është pajisur me vërtetimin e kolaudit nga organi përgjegjës i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. _____, datë _____, dhe plotëson kushtet e mbrojtjes nga zjarri, për të cilën është pajisur me aktin nr. _____, datë _____.

Magazina ka një kapacitet magazinimi _____ ton lëndë plasëse, _____ copë/ml kapsolla, fitil zjarrpërcjellës.

Magazina është e pajisur me kamera sigurie në bazë të kërkesave të ligjit “Për masat shtesë të sigurisë” dhe për ruajtjen dhe sigurinë e saj është lidhur kontratë me subjektin e SHPSF _____.

Sa më sipër, kërkoj të pajisem me autorizim për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil.

Bashkëlidhur me kërkesën, dorëzohen dokumentet që vërtetojnë plotësimin e kriterëve për magazinimin e lëndëve plasëse.

KËRKUESI



Lidhja nr. 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

KËRKESË

Për pajisjen me autorizim për transferim të lëndëve plasëse

Drejtuar: Strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Brendshme

Unë _____, administrator i subjektit _____, i pajisur nga Ministria e Mbrojtjes/Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me licencë/autorizim nr. _____, “Për import/eksport/prodhim/përdorim të lëndëve plasëse për përdorim civil”, me adresë të selisë _____, me drejtues teknik _____, me adresë të magazinës _____, paraqes kërkesën, si më poshtë:

Ushtroj aktivitetin për prodhimin/import/eksport/përdorimin të lëndëve plasëse për përdorim civil në qytetin _____, i cila është në juridiksionin e Komisarariatit të Policisë _____.

Kam në pronësi/qira një magazinë në _____, për të cilën jam pajisur nga Policia e Shtetit me autorizim nr. _____, datë _____, për magazinimin e lëndëve plasëse me afat deri më _____ dhe subjekti që pret mallin është i licencuar për ushtrimin e aktivitetit me lëndët plasëse dhe pajisur nga Policia e Shtetit me autorizim nr. _____, datë _____, për magazinimin e lëndëve plasëse me afat deri më _____.

Transferimi i lëndëve plasëse do të kryhet me automjetin tip _____, me targa _____ dhe drejtues mjeti _____, të cilët janë të pajisur me certifikatë ADR nr. _____, datë _____. Mjeti plotëson kushtet e mbrojtjes nga zjarri dhe është i pajisur me mjetet mbrojtëse të nevojshme.

Shoqërimi i lëndës plasëse do të kryhet nga shtetasi _____, i pajisur me dëshminë e zjarrmëtarit nr. _____, datë _____, si dhe nga punonjësi i SHPSF/Policia e Shtetit _____, sipas kontratës.

Subjekti ka lidhur kontratë me subjektin e SHPSF _____/Policinë e Shtetit për shoqërimin e automjetit që do të kryejë transferimin e lëndëve plasëse.

Sa më sipër, kërkoj të pajisem me autorizim për transferimin e lëndëve plasëse për përdorim civil.

Bashkëlidhur me kërkesën, dorëzohen dokumentet që vërtetojnë plotësimin e kritereve për transferimin e lëndëve plasëse.

KËRKUESI



Lidhja nr. 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

KËRKESË**Për pajisjen me autorizim për asgjësim të lëndëve plasëse**

Drejtuar: Strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Brendshme _____

Unë _____, administrator i subjektit _____, i pajisur nga Ministria e Mbrojtjes/ Infrastrukturës dhe Energjisë me licencë/autorizim nr. _____, “Për import/eksport/prodhim/përdorim të lëndëve plasëse për përdorim civil”, me adresë të selisë _____, me drejtues teknik _____, me adresë të magazinës _____, paraqes kërkesën, si më poshtë:

Ushtroj aktivitetin për prodhimin/import/eksport/përdorimin të lëndëve plasëse për përdorim civil në qytetin _____, i cili është në juridiksionin e Komisarariatit të Policisë _____.

Kam në pronësi/qira një magazinë në _____, për të cilën jam pajisur nga Policia e Shtetit me autorizim nr. _____, datë _____, për magazinimin e lëndëve plasëse, me afat deri më _____.

Në magazinë kam një sasi prej _____ lëndësh plasëse, e cila është e skaduar, jashtë përdorimit dhe duhet asgjësuar.

Kam lidhur marrëveshje me subjektin e licencuar nga Ministria e Mbrojtjes, i cili ofron shërbimin e asgjësimit të lëndëve plasëse. Asgjësimi do të kryhet në ambientin e caktuar nga subjekti i licencuar nga Ministria e Mbrojtjes për asgjësimin e lëndëve plasëse të skaduara.

Shoqërimi i lëndës plasëse të skaduar do të kryhet nga shtetasi _____, i pajisur me dëshminë e zjarrmëtarit nr. _____, datë _____.

Subjekti ka në pronësi/qira automjet tip _____, me targa _____ për transportin e lëndëve plasëse të skaduara, i cili plotëson kushtet e mbrojtjes nga zjarri dhe është pajisur me mjetet mbrojtëse përkatëse.

Subjekti ka lidhur kontratë me subjektin e SHPSF _____/Policinë e Shtetit për shoqërimin e automjetit që do të kryejë transportin e lëndëve plasëse të skaduara.

Sa më sipër, kërkoj të pajisem me autorizim për asgjësimin e lëndëve plasëse për përdorim civil të skaduara.

Bashkëlidhur me kërkesën, dorëzohen dokumentet që vërtetojnë plotësimin e kriterëve për asgjësimin e lëndëve plasëse.

KËRKUES



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

AUTORIZIM

Për magazinim të lëndëve plasëse për përdorim civil

Bazuar në kërkesën nr. _____, datë _____, të subjektit _____, i pajisur nga Ministria e Mbrojtjes/Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me licencë/autorizim nr. _____, datë _____, me administrator z. _____ dhe drejtues teknik z. _____, me seli në _____, me adresë të magazinës _____, pas verifikimeve të kryera nga struktura përgjegjëse në Komisaratin e Policisë _____ u konstatua se:

Ky subjekt ushtron aktivitetin për prodhimin/import/eksport/përdorimin të lëndëve plasëse për përdorim civil në qytetin _____, i cili është në juridiksionin e Komisariatit të Policisë _____.

Subjekti plotëson kërkesat dhe është pajisur me vërtetimin e kolaudit nga organi përgjegjës i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. _____, datë _____, dhe magazina plotëson kushtet e mbrojtjes nga zjarri, pajisur me aktin nr. _____, datë _____.

Magazina është e pajisur me kamera sigurie në bazë të kërkesave të ligjit “Për masat shtesë të sigurisë” dhe për ruajtjen dhe sigurinë e saj subjekti ka lidhur kontratë me subjektin e SHPSF _____.

Subjekti autorizohet të magazinojë lëndë plasëse dhe kapsolla detonatorë/fetil zjarrpërcjellës, sipas kapacitetit të magazinës, si më poshtë:

1. Lëndë plasëse për përdorim civil _____ ton.
2. Kapsolla detonatorë fitil zjarrpërcjellës _____ copë/ml.

Afati i autorizimit është nga data _____, deri më datë _____.

KOMISIONI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

AUTORIZIM

Për transferimin e lëndëve plasëse për përdorim civil

Bazuar në kërkesën nr. _____, datë _____, të subjektit _____, i pajisur nga Ministria e Mbrojtjes/ Infrastrukturës dhe Energjisë me licencë/autorizim nr. _____, datë _____, me administrator z. _____ dhe drejtues teknik z. _____, me seli në _____, me adresë të magazinës _____, pas verifikimeve të kryera nga struktura e Rendit të Komisarariatit të Policisë _____ u konstatua se:

Ky subjekt ushtron aktivitetin për prodhimin/import/eksport/përdorimin të lëndëve plasëse për përdorim civil në qytetin _____, i cili është në juridiksionin e Komisarariatit të Policisë _____.

Subjekti është pajisur me autorizim për magazinim të lëndëve plasëse nr. _____, datë _____, dhe subjekti pritës i mallit është pajisur me autorizim për magazinim të lëndëve plasëse _____, datë _____.

Transferimi i lëndëve plasëse do të kryhet me automjetin tip _____, me targa _____ dhe drejtuesi i mjetit _____, të cilët janë të pajisur me certifikatë ADR nr. _____ datë _____, plotësojnë kushtet e mbrojtjes nga zjarri dhe mjeti është i pajisur me mjetet mbrojtëse të nevojshme.

Shoqërimi i lëndës plasëse do të kryhet nga shtetasi _____, i pajisur me dëshminë e zjarrmëtarit nr. _____, datë _____, si dhe nga punonjësi i SHPSF/Policia e Shtetit _____, sipas kontratës.

Subjekti autorizohet të transferojë lëndë plasëse dhe kapsolla detonatorë/fitil zjarrpërcjellës, si më poshtë:

1. Lëndë plasëse për përdorim civil _____ ton.
2. Kapsolla detonatorë fitil zjarrpërcjellës _____ copë/ml.

Afati i autorizimit është data _____.

KOMISIONI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

AUTORIZIM

Për asgjësimin e lëndëve plasëse për përdorim civil

Bazuar në kërkesën nr. _____, datë _____, të subjektit _____, i pajisur nga Ministria e Mbrojtjes/Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me licencë/autorizim nr. _____, datë _____, me administrator z. _____ dhe drejtues teknik z. _____, me seli në _____, me adresë të magazinës _____, pas verifikimeve të kryera nga struktura përgjegjëse në Komisaratin e Policisë _____ u konstatua se:

Ky subjekt ushtron aktivitetin për prodhimin/import/eksport/përdorimin të lëndëve plasëse për përdorim civil në qytetin _____ ka deklaruar se në magazinën e lëndëve plasëse ka një sasi _____ lëndë plasëse të skaduar, e cila duhet asgjësuar.

Subjekti ka lidhur marrëveshje me subjektin e licencuar nga Ministria e Mbrojtjes për asgjësimin e lëndëve plasëse të skaduara, i cili ofron shërbimin e asgjësimit të lëndëve plasëse në ambientin e caktuar nga subjekti i licencuar.

Shoqërimi i lëndës plasëse të skaduar do të kryhet nga shtetasi _____, i pajisur me dëshminë e zjarrmëtarit nr. _____, datë _____.

Subjekti ka në pronësi/qira automjet tip _____ me targa _____ për transportin e lëndëve plasëse të skaduar, i cili plotëson kushtet e mbrojtjes nga zjarri dhe është pajisur me mjetet e nevojshme.

Subjekti _____ autorizohet të asgjësojë lëndë plasëse dhe kapsolla detonatorë/fartil zjarrpërcjellës, si më poshtë:

1. Lëndë plasëse për përdorim civil _____ ton.
2. Kapsolla detonatorë fitil zjarrpërcjellës _____ copë/ml.

Afati i autorizimit është data _____.

KOMISIONI

**VENDIM****Nr. 49, datë 31.1.2024****PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT TË
PAGESËS SË QIRASË PËR STREHIM
PËR PUNONJËSIT E AGJENCISË SË
MBIKËQYRJES POLICORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 73, të ligjit nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kriterëve dhe të masës së përfitimit të pagesës së qirasë për strehim për punonjësit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, të cilët transferohen në detyrë jashtë vendbanimit të përhershëm brenda vendit dhe të cilëve nuk u sigurohet nga Agjencia mjedisi për akomodim.

2. Kur punonjësi nuk ka në ngarkim persona të tjerë familjarë, me të cilët zhvendoset jashtë vendbanimit të përhershëm, i paguhet qiraja e banesës për sipërfaqe banimi deri në 30 (tridhjetë) m² neto. Për çdo person familjar shtesë, sipërfaqja neto shtohet me 10 (dhjetë) m².

3. Punonjësi i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, që transferohet jashtë vendbanimit të tij të përhershëm brenda vendit, përfiton kompensim për qira banese, nëse transferohet për shkak të detyrës, për nevoja pune, në largësi mbi 36 km.

4. Numri i personave, pjesëtarë të familjes, në ngarkim të punonjësit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, vërtetohet nëpërmjet certifikatës familjare, në momentin e transferimit.

5. Masa e përfitimit të kompensimit për strehim të jetë sa vlera minimale e qirasë mujore, sipas përcaktimeve në pikën 2, të vendimit nr. 469, datë 3.6.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”.

6. Punonjësi i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, që përfiton kompensim për qira banese, paraqet pranë strukturës përgjegjëse të burimeve njerëzore dokumentet e mëposhtme:

a) kërkesën me shkrim për kompensimin e qirasë së banesës;

b) fotokopjen e kartës së identitetit;

c) kontratën e noterizuar të qirasë së banesës ku është transferuar;

ç) vërtetimin nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës se ai ose pjesëtarët e familjes, që ka në certifikatën e gjendjes familjare, nuk kanë banesë apo nuk kanë aplikuar për legalizim banese, në juridiksionin ku është emëruar ose transferuar.

7. Punonjësi përfiton kompensim për qira, sipas këtij vendimi, për atë kohë sa zgjat transferimi i tij, ose deri në sistemimin me banesë të përhershme në vendin e punës ku është transferuar.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****VENDIM****Nr. 51, datë 31.1.2024****PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE
TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË SË
INTELIGJENCËS FINANCIARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr. 9917 datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Inteligjencës Financiare (AIF), si person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për financat (në vijim ministri), me seli në Tiranë.

2. AIF-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Buxheti i AIF-së përbën zë të veçantë në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për financat.

4. Misioni i AIF-së është të parandalojë pastrimin e parave e të produkteve që burojnë nga veprat penale, si dhe parandalimin e financimit të terrorizmit, duke bashkëpunuar me institucionet



dhe organet kompetente kombëtare e ndërkombëtare për këtë qëllim.

5. Në zbatim të ligjit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, AIF-ja:

- a) ushtron funksionet e autoritetit përgjegjës;
- b) funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

6. AIF-ja ka si fushë përgjegjësie:

- a) parandalimin e pastrimit të parave dhe produkteve që burojnë nga veprat penale;
- b) parandalimin e financimit të terrorizmit.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË AGJENCISË SË INTELIGJENCËS FINANCIARE

1. AIF-ja përmbush objektivat, kryen detyrat dhe ushtron përgjegjësitë në përputhje me përcaktimet e legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave e financimit të terrorizmit, si dhe legjislacionit për masat kundër financimit të terrorizmit.

2. AIF-ja ka përgjegjësi të organizojë punën për:

- a) ushtrimin e funksionit për parandalimin e pastrimit të parave e të produkteve që burojnë nga veprat penale;
- b) ushtrimin e funksionit për parandalimin e financimit të terrorizmit;
- c) mbledhjen, përpunimin, vlerësimin, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të të dhënave dhe informacioneve për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave e financimit të terrorizmit;
- ç) mbikëqyrjen e përputhshmërisë së veprimtarisë së subjekteve të ligjit me kërkesat e akteve ligjore e nënligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË SË INTELIGJENCËS FINANCIARE

1. AIF-ja e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.

2. Struktura dhe organika e AIF-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

3. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e nëpunësve e të punonjësve adminis-

trativë të AIF-së miratohet nga ministri përgjegjës për financat, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm. Rregullorja, ndër të tjera, parashikon edhe procedurat e ristrukturimit, pranimit dhe rekrutimit të nëpunësve e të punonjësve administrativë, të pezullimit, transferimit të tyre, llojet e masave disiplinore dhe procedurën e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore e të vendosjes së masave disiplinore.

4. AIF-ja ka stemën, logon dhe vulën zyrtare.

5. Stema e AIF-së ka shënimet “Republika e Shqipërisë”, Ministria e (emri i ministrisë përgjegjëse), “Agjencia e Inteligjencës Financiare”, në përputhje me përcaktimin e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

6. Vula e AIF-së ka elementet dhe formën e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, të kontrollit dhe të ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. AIF-ja drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Drejton AIF-në dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët, brenda dhe jashtë vendit;
- b) Nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda vendit dhe me agjenci homologe të huaja apo organizma të tjerë jashtë vendit, që iu nënshtrohen detyrimeve të ngjashme të konfidencialitetit, në funksion të ushtrimit të detyrave e të funksioneve të saj;
- c) Raporton me shkrim drejtpërdrejt te ministri përgjegjës për financat dhe Kryeministri, sa herë që i kërkohet, por jo më pak se dy herë në vit për veprimtarinë e AIF-së dhe problematikat e hasura lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

ç) Raporton sa herë që i kërkohet në komisionet parlamentare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për veprimtarinë e AIF-së në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

d) Informon në mënyrë periodike, me shkrim, për veprimtarinë e AIF-së Komitetin e Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave;

dh) Organizon dhe drejton analiza periodike të aktivitetit të AIF-së;



e) Krijon grupe pune për çështje specifike të punës së AIF-së dhe monitoron ecurinë e përmbushjes së qëllimit të tyre;

ë) Organizon punën për hartimin dhe publikimin në afat të raportit vjetor;

f) Miraton programe të kualifikimit profesional të nëpunësve të AIF-së;

g) Drejton dhe orienton punën e grupit teknik ndërinstitucional për parandalimin e pastrimit të parave, në kuadër të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave;

gj) Bashkërendon punën për mbikëqyrjen e përmbushjes së detyrimeve të subjekteve të ligjit sipas dispozitave ligjore në fuqi;

h) Merr vendim për dhënien e masave administrative për kundërvajtjet administrative të kryera nga subjektet e legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;

i) Është përgjegjës për ngritjen dhe zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në institucion, në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi;

j) Bashkërendon punën për menaxhimin e burimeve njerëzore, çështjeve ligjore, teknologjisë së informacionit, mirëmbajtjen e shërbimeve të tjera mbështetëse, si dhe për përgatitjen e zbatimin e buxhetit dhe mbajtjen e kontabilitetit;

k) Kryen çdo funksion tjetër si titullar institucioni, sipas legjislacionit në fuqi.

8. Drejtori i përgjithshëm i AIF-së emërohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat.

9. Drejtor i përgjithshëm i AIF-së emërohet personi, sipas procedurës së parashikuar në këtë vendim, i cili duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të jetë i aftë nga ana shëndetësore;

ç) të zotërojë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike, në “Shkenca juridike ose ekonomike”;

d) të ketë të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) vite eksperiencë në punë, nga të cilat së paku 5 (pesë) vite në nivel drejtues në administratën publike;

dh) të mos jetë larguar për shkelje disiplinore nga administrata publike, si dhe të mos ketë masë

disiplinore që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

e) të mos i jetë hequr e drejta për të ushtruar funksione publike me vendim gjyqësor të formës së prerë;

ë) të mos ketë filluar ndjekja penale ndaj tij;

f) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

g) të plotësojë kushtet e sigurisë për kontrollin e verifikimit të pasurisë e të figurës;

gj) të mos ketë konflikt interesi me detyrën ose funksionin që do të kryejë, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave.

10. Drejtori i përgjithshëm i AIF-së lirohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat kur:

a) plotëson moshën për pension pleqërie;

b) jep dorëheqjen nga detyra;

c) humbet shtetësinë shqiptare;

ç) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor apo merr formë të prerë vendimi gjyqësor për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;

d) nuk mund të ushtrojë detyrën për një periudhë kohore të pandërprerë, më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj;

dh) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

e) ka konflikt të vazhdueshëm interesi me detyrën që kryen, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave;

ë) i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike me vendim gjyqësor të formës së prerë;

f) emërohet në një detyrë tjetër.

11. Drejtori i përgjithshëm i AIF-së shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat kur:

a) konstatohen shkelje të dispozitave të ligjit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

b) i hiqet ose i refuzohet certifikata e sigurisë sipas legjislacionit në fuqi;

c) kryen akte dhe sjellje që diskreditojnë pozitën dhe figurën e tij apo reputacionin e institucionit;

ç) kryen veprimtari që krijon konflikt interesash, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave;

d) mungon në detyrë, pa shkaqe të arsyeshme, për më shumë se 30 (tridhjetë) ditë rresht/në vijim;



dh) kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës.

12. AIF-ja, në përmbushje të misionit, fushave të përgjegjësisë e të përgjegjësiwe funksionale të saj, kryen detyrat, si më poshtë vijon:

a) Mbledh, administron, përpunon, analizon dhe shpërndan tek autoritetet kompetente të dhëna, raporte dhe informacione për çështjet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

b) Shkëmben informacion me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Prokurorinë e Posaçme, Policinë e Shtetit, Byronë Kombëtare të Hetimit, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe autoritetet e tjera kompetente të zbatimit të ligjit apo të inteligjencës për çështjet e pastrimit të produkteve të veprës penale, veprat penale ose veprimtaritë kriminale që gjenerojnë produkte të veprës penale dhe financimit të terrorizmit;

c) Shkëmben informacion me çdo agjenci të huaj homologe, në varësi të detyrimeve të ngjashme të konfidencialitetit;

ç) Mbikëqyr përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve me kërkesat e akteve ligjore e nënligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përfshirë inspektimet në vend e në distancë, vetëm ose në bashkëpunim me autoritetet mbikëqyrëse;

d) Kryesisht, në bazë të një vendimi të Këshillit të Ministrave, apo për rastet e kërkuara nga Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar, organizma të tjerë ndërkombëtarë, nga të cilët lindin detyrime për Republikën e Shqipërisë, nxjerr listë të vendeve për kufizimin dhe/ose kontrollin e transaksioneve apo marrëdhënieve të biznesit të subjekteve, proporcionalisht me rreziqet e evidentuara, vendime këto të detyrueshme për zbatim nga subjektet dhe autoritetet shtetërore që kanë detyrime sipas këtij ligji;

dh) Organizon dhe merr pjesë, së bashku me institucionet publike e private, në veprimtaritë trajnuese për parandalimin e pastrimit të parave e të financimit të terrorizmit, si dhe organizon ose merr pjesë në programe për të rritur ndërgjegjësimin e publikut;

e) Njofton autoritetin përkatës mbikëqyrës, kur vëren se një subjekt nuk i përmbush detyrimet e përcaktuara në këtë ligj;

ë) Publikon brenda tremujorit të parë të çdo viti raportin publik vjetor për vitin pararendës për veprimtarinë e autoritetit përgjegjës;

f) Rishikon periodikisht efektivitetin dhe frytshmërinë e sistemit vendas për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

13. Marrëdhënia e punës së nëpunësve të AIF-së është një marrëdhënie juridike e natyrës administrative, me qëllim krijimin e një strukture inteligjence financiare të qëndrueshme, profesionale, të bazuar në meritë dhe integritet.

14. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm, nëpunësve dhe punonjësve administrativë të AIF-së rregullohen sipas dispozitave në fuqi të Kodit të Punës.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) me hyrjen në fuqi të këtij vendimi ristrukturohet në Agjencinë e Inteligjencës Financiare (AIF).

2. Deri në miratimin e akteve nënligjore të AIF-së, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë funksionale do të vijojnë të ushtrohen sipas strukturës dhe organikës së miratuar.

3. Nëpunësit dhe punonjësit administrativë të DPPPP-së transferohen pranë AIF-së.

4. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i AIF-së që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të marrë masat për hartimin dhe paraqitjen e propozimit për miratimin e rregullores për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e nëpunësve e të punonjësve administrativë të AIF-së.

5. Vendimi nr. 457, datë 10.6.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave”, shfuqizohet.

6. Ngarkohet Agjencia e Inteligjencës Financiare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr. 52, datë 31.1.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 564, DATË 31.7.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KRITERET DHE PROCEDURAT PËR
MBROJTJEN E VEÇANTË TË
MAGJISTRATIT GJATË USHTRIMIT TË
FUNKSIONIT OSE PËR SHKAK TË TIJ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 20, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 564, datë 31.7.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pika 17 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“17. Subjektet e përcaktuara në pikën 4, të këtij vendimi, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të masave të mbrojtjes, mund të paraqesin para komisionit kërkesë për zgjatjen e këtij afati. Komisioni mund të vendosë zgjatjen e afatit të masave të mbrojtjes kur rrethanat, për të cilat është siguruar më parë mbrojtja, vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas përfundimit të këtij afati ose kur ka të dhëna të tjera të besueshme që provojnë se magjistrati i rrezikohen jeta, familja apo pasuria.”.

b) Pas pikës 17 shtohen pikat 17/1 dhe 17/2, me këtë përmbajtje:

“17/1. Komisioni, edhe kryesisht, pas një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e masave të mbrojtjes, si dhe sa herë të konsiderohet e nevojshme, përpara përfundimit të afatit të mbrojtjes, bën verifikimin e kushteve për të përfutur mbrojtje të veçantë dhe të nevojave të sigurimit. Në përfundim të verifikimit, Komisioni merr vendim për zgjatjen e afatit të masave të mbrojtjes, shtimin ose pakësimin e tyre apo ndërprerjen e mbrojtjes së veçantë.

17/2. Gjatë afatit, brenda të cilit sigurohet mbrojtja e veçantë, magjistrati, magjistrati që nuk e ushtron funksionin ose magjistrati që ka dalë në pension, si dhe familjarët e tij, janë të detyruar që:

a) të bashkëpunojnë në mënyrë aktive për zbatimin e vendimit të Komisionit;

b) të mënjanojnë çdo veprim ose mosveprim, që mund të rrezikojë zbatimin e mbrojtjes së veçantë apo që mund të sjellë, si pasojë, një gjendje tjetër rreziku për ta ose për jetën dhe shëndetin e shoqëruesve personalë;

c) të informojnë menjëherë Komisionin për çështje që kërkojnë prej tij ose për ngjarje apo ndryshime të rrethanave të jetës a veprimtarive të tij personale, si dhe për kontaktet e marrëdhëniet me të tretë, që mund të rrezikojnë zbatimin e mbrojtjes së veçantë;

ç) të pranojnë, nëse është e domosdoshme për qëllimet e mbrojtjes, përdorimin në mjediset e veta të mjeteve teknike të ruajtjes, vëzhgimit dhe regjistrimit pamor dhe/ose zanor.”.

2. Ngarkohen ministri i Drejtësisë, ministri i Brendshëm, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 3, datë 26.1.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Bazuar në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, në nenet 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin të Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, të kompetencave funksionale si vijon:

a) lëshimin e autorizimeve për përfaqësim ligjor, të Ministrisë së Financave, në proceset gjyqësore ku thirret si palë në gjykim apo si subjekt i interesuar dhe nënshkrimin e akteve procedurale, të tilla si: kërkesëpadi, ankime, rekurse, kërkesa për pezullim ekzekutim vendimi;

b) përcaktimin e numrit të punonjësve që shoqërojnë delegacionet e huaja dhe miratimin e



programeve për shërbimet e pritje përcjellje që organizon ministri i Financave;

c) miratimin e kërkesave për kryerjen e orëve shtesë të punës, për punonjësit e strukturës së ministrisë, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) nënshkrimin e kontratave të punës, si dhe aktet për përfundimin e marrëdhënies së punës, për pozicionet që rregullohen me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë;

d) kryerjen e të gjitha veprimeve administrative dhe procedurale në funksion të miradministrimit të burimeve njerëzore të sistemit ministror, me përjashtim të atyre që sipas legjislacionit në fuqi u janë ngarkuar organeve kompetente.

2. Delegimin e autorizimit, për dërgim me shërbim jashtë vendit dhe brenda vendit në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës, të nëpunësve të Ministrisë së Financave dhe institucioneve të varësisë, të zëvendësministrit të Ministrisë së Financave, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, zëvendësministri, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Financave dhe institucionet e varësisë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCEVE
Ervin Mete

URDHËR
Nr. 15, datë 15.1.2024

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“MBI FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT
VLERËSUES TË CERTIFIKIMIT TË
SUBJEKTEVE QË USHTROJNË
VEPRIMTARINË E AGROTURIZMIT,
PROCEDURAT E APLIKIMIT, TË
VLERËSIMIT PARAPRAK DHE
PËRFUNDIMTAR, SI DHE PEZULLIMI
DHE/OSE SHFUQIZIMI I
‘CERTIFIKATËS PARAPRAKE’
APO I ‘CERTIFIKATËS’”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, dhe të pikës 14, të vendimit nr. 22, datë 12.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin

e kriterëve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij”, të ndryshuar; të vendimit nr. 730, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifën, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, të ndryshuar,

URDHËROJMË:

1. Miratimin e rregullores “Mbi funksionimin e Komisionit Vlerësues të Certifikimit të Subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit, procedurat e aplikimit, të vlerësimit paraparak dhe përfundimtar, si dhe pezullimi dhe/ose shfuqizimi i “Certifikatës paraprake” apo i “Certifikatës”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Miratimin e modelit të “Certifikatës paraprake për veprimtari pritëse të certifikuar si agroturizëm” dhe certifikatës “Subjekt i certifikuar për veprimtarinë e agroturizmit” dhe shenjës dalluese në certifikatë sipas aneksit 2.

3. Urdhri i përbashkët nr. 32, datë 26.1.2021, “Për miratimin e rregullores mbi funksionimin e Komisionit Vlerësues të Certifikimit të Subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit, procedurat e aplikimit, të vlerësimit paraparak dhe përfundimtar, si dhe pezullimi dhe/ose shfuqizimi i ‘Certifikatës paraprake’ apo i ‘Certifikatës’”, shfuqizohet.

4. Urdhri i përbashkët nr. 312, datë 9.9.2019, “Për miratimin e modelit të certifikatës paraprake, certifikatës ‘Subjekt i Certifikuar për Veprimtarinë e Agroturizmit’ dhe shenjës dalluese”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Komisioni Vlerësues.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

**RREGULLORE**

**MBI FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT
VLERËSUES TË CERTIFIKIMIT TË
SUBJEKTEVE QË USHTROJNË
VEPRIMTARINË E AGROTURIZMIT,
PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË
VLERËSIMIT PARAPRAK DHE
PËRFUNDIMTAR, SI DHE PEZULLIMI
DHE/OSE SHFUQIZIMI I “CERTIFIKATËS
PARAPRAKE” APO I “CERTIFIKATËS”**

**KREU I
TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e mënyrës së organizimit dhe të funksionimit të Komisionit Vlerësues të Certifikimit të Subjekteve (më poshtë “Komisioni”), që ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit, përcaktimin e procedurave të aplikimit dhe të vlerësimit të tyre për subjektet që aplikojnë për marrjen e “Certifikatës paraprake” ose “Certifikatës”, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyrën e ushtrimit dhe zbatimit të tyre, si dhe rastet e pezullimit dhe/ose shfuqizimit të “Certifikatës paraprake” apo “Certifikatës”.

**Neni 2
Përkufizime**

Të gjithë termat e përcaktuara në vendimin nr. 22, datë 12.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij”, të ndryshuar (më poshtë “VKM-ja nr. 22/2018, e ndryshuar”) kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- a) “Shoqëria e bashkëpunimit bujqësor” (SHBB) është shoqëria sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 38/2012, “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”;
- b) “Organizata”, janë organizatat sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar;
- c) “Aplikim elektronik” është aplikim nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*, ku të mundësohet aplikimi për pajisjen me “Certifikatë paraprake” apo

“Certifikatë” për ushtrimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ngarkimi i dokumenteve që shoqërojnë aplikimin.

**KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
KOMISIONIT**

**Neni 3
Statusi i Komisionit**

1. Komisioni është organ kolegjial, vendim-marrës, i ngritur pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe funksionon sipas kësaj rregulloreje, dhe legjislacionit në fuqi për organet kolegjiale, për aq sa nuk është parashikuar në këtë rregullore.

2. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për certifikimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit, për dhënien, pezullimin dhe/ose shfuqizimin e “Certifikatës paraprake” dhe “Certifikatës”, sipas kushteve dhe kriterëve të certifikimit të veprimtarive të agroturizmit të përcaktuara në VKM-në nr. 22/2018, të ndryshuar.

**Neni 4
Përbërja**

Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë:

- a) tre përfaqësues nga ministria përgjegjëse për turizmin;
- b) dy përfaqësues nga ministria përgjegjëse për bujqësinë.

**Neni 5
Organizimi i Komisionit**

1. Komisioni ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin. Ministri përgjegjës për bujqësinë, propozon dy përfaqësues për këtë komision dhe kryen funksionet sipas kësaj rregulloreje. Urdhri për ngritjen e Komisionit të certifikimit të subjekteve të agroturizmit përcakton në mënyrë nominale kryetarin dhe anëtarët e Komisionit.

2. Në rast se kryetari mungon ose është në pamundësi për të ushtruar kompetencat, anëtari me i vjetër në detyrë i Komisionit merr dhe ushtron kompetencat për drejtimin e Komisionit.

3. Komisioni, në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi të tij, asistohet nga sekretariati teknik, rolin e të cilit e luan Drejtoria e Përgjithshme për



Zhvillimin e Turizmit, pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin.

Neni 6

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) merr në shqyrtim të gjitha aplikimet e paraqitura nga subjektet në mënyrë elektronike, në sistemin *e-Albania*, që aplikojnë për t'u pajisur me "Certifikatë paraprake" dhe "Certifikatën", të përcjella nëpërmjet sekretariatit teknik;

b) merr vendim për lëshimin e "Certifikatës paraprake" ose "Certifikatës", ose refuzimin e aplikimit të subjektit për t'u pajisur me këto certifikata, në rast të mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara në VKM-në nr. 22/2018, të ndryshuar;

c) shqyrton përputhshmërinë e kërkesave për zgjatjen e afatit të "Certifikatës paraprake" në përputhje me afatin e lejes së ndërtimit.

Neni 7

Funksionimi i Komisionit

1. Komisioni mbledhet minimalisht brenda 15 ditë-punëve nga data e depozitimit për shqyrtim të një aplikimi. Komisioni mund të mbledhet edhe kur shumica e anëtarëve paraqesin kërkesë me shkrim, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje.

2. Mbledhjet e Komisionit asistohen nga sekretariati teknik, i cili është përgjegjës për shpërndarjen e materialeve përkatëse të të gjithë anëtarët e Komisionit.

3. Në qoftë se aplikimi i subjektit për pajisjen me "Certifikatë paraprake" apo "Certifikatë" nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM-në nr. 22/2018, të ndryshuar, sekretariati teknik, brenda 5 (pesë) ditë-punëve nga data e aplikimit në portalin *e-Albania*, njofton aplikuesin, nëpërmjet portalit *e-Albania*, për plotësimin e dokumentacionit ose korrigjimin e pasaktësive dhe i cakton atij një afat prej 14 (katërmëdhjetë) ditë-punësh, për ngarkimin e dokumentacionit përkatës.

4. Sekretariati teknik njofton kryetarin e Komisionit për çdo aplikim të hedhur në portalin *e-Albania* për pajisjen me "Certifikatë paraprake" apo "Certifikatën", si dhe për çdo problematikë të paraqitur nga organet konstatuese. Kryetari i Komisionit vendos për datën, kohën, rendin e ditës

dhe vendin e mbledhjeve në përputhje me afatet e përcaktuara në këtë urdhër.

5. Data e mbledhjes u njoftohet anëtarëve të Komisionit, të paktën 3 (tri) ditë-pune përpara datës së caktuar për zhvillimin e saj. Anëtarët e Komisionit njoftohen nga sekretariati teknik, në rrugë elektronike, për çdo ndryshim në datën, kohën dhe vendin e caktuar për mbledhje.

6. Sekretariati teknik përgatit rendin e ditës së bashku me dokumentacionin përkatës duke jua përcjellë paraprakisht, elektronikisht dhe në mbledhjen e radhës i vendos në dispozicion të çdo anëtari.

7. Sekretariati teknik mban procesverbalin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës. Votat e anëtarëve regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes.

Neni 8

Procedura e marrjes së vendimeve

1. Komisioni merr vendim të lëshojë ose jo, sipas rastit, "Certifikatën paraprake" apo "Certifikatën", lidhur me çdo aplikim që është paraqitur nga subjektet e interesuara.

2. Komisioni merr vendim, sipas rastit, të pezullojë dhe/ose të shfuqizojë "Certifikatën paraprake" apo "Certifikatën".

3. Komisioni, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë-punëve nga data e aplikimit në portalin *e-Albania* të aplikuesit ose nga data e ngarkimit të dokumentacionit të plotë në portalin *e-Albania*, e shqyrton atë dhe i parashtrohet brenda 5 (pesë) ditë-punëve ministrit përgjegjës për turizmin vendimin e Komisionit për lëshimin ose jo të "Certifikatës paraprake" ose "Certifikatës".

4. Në rast se Komisioni refuzon aplikimin për pajisjen me "Certifikatën paraprake" ose "Certifikatën", vendimi duhet të jetë i arsyetuar dhe i njoftohet subjektit brenda 5 (pesë) ditë-punëve nga vendimmarrja e Komisionit.

5. Në rast se Komisioni, gjatë shqyrtimit të aplikimit dhe dokumentacionit shoqëruar, konstaton parregullsi apo lundin dyshime të arsyeshme për të dhënat e deklaruara, si dhe për përmbajtjen e dokumentacionit, sipas rastit ngrihet një grup pune me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin për verifikimin në terren të të dhënave. Komisioni, nëpërmjet sekretariatit teknik, njofton subjektin dhe



grupin e verifikimit, si dhe koordinon vizitën në terren.

6. Grupi i punës i paraqet Komisionit raportin përmbledhës të gjetjeve të konstatuara, brenda 5 (pesë) ditë-punëve nga dita e verifikimit.

7. Ndaj vendimit të Komisionit mund të ushtrohet ankim nga marrja dijeni e njoftimit, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

8. Komisioni i zhvillon mbledhjet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Komisioni i merr vendimet me votim të hapur dhe me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të tij të pranishëm në mbledhje. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.

9. Komisioni mban procesverbal, në të cilën pasqyrohet procedura që ndiqet për shqyrtimin e aplikimit, si dhe vendimmarrja e Komisionit. Procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit të pranishëm në mbledhje.

10. Ministri përgjegjës për turizmin, bazuar në vendimin e Komisionit, lëshon “Certifikatën paraprake” apo “Certifikatën” për çdo subjekt.

Neni 9

Votimi i detyrueshëm

1. Kryetari i Komisionit i fton anëtarët, që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë pengesë ligjore për të votuar, të votojnë, duke votuar vetë i fundit.

2. Anëtarët e Komisionit që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë pengesë ligjore për të votuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, nuk mund të abstenojnë.

Neni 10

Deklarimi i pengesave ligjore

1. Në rastet kur një anëtar i Komisionit është i prekur nga një pengesë ligjore, sipas legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesave, ai duhet të lajmërojë menjëherë kryetarin e Komisionit.

2. Kryetari merr vendim për përjashtimin nga votimi të anëtarit të Komisionit, në rast kërkesë, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Kur kërkesa për përjashtimin e një anëtarit të Komisionit bëhet jo nga vetë anëtarit, por nga një palë e interesuar, kryetari e merr vendimin për përjashtimin ose jo, pas një hetimi të gjithanshëm

dhe pasi dëgjon dhe argumentet e anëtarit që dyshohet se ka pengesë ligjore.

4. Në rastet kur vetë kryetari preket ose dyshohet se preket nga një pengesë ligjore, vendimin për përjashtimin ose mospërjashtimin e tij nga votimi e merr vetë Komisioni.

5. Në çdo rast, vendimi për përjashtimin ose jo nga votimi të një anëtarit apo të kryetarit të Komisionit merret brenda 5 (pesë) ditë-punëve nga dita kur vetë anëtarit deklaron pengesën ose kur pala e interesuar bën kërkesën. Në këtë rast, atributet e kryetarit i merr anëtarit më i vjetër në detyrë me të drejtë vote.

6. Anëtarët e Komisionit që kanë pengesë ligjore për të votuar nuk duhet të jenë të pranishëm gjatë diskutimeve dhe gjatë votimit.

Neni 11

Konfidencialiteti

Anëtarët e Komisionit duhet të ruajnë sekretin profesional dhe konfidencialitetin e diskutimeve, dokumenteve dhe çdo informacioni që u vihet në dispozicion gjatë zbatimit të procedurave të certifikimit sipas legjislacionit në fuqi.

KREU III

PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË VLERËSIMIT

Neni 12

Kriteret e nevojshme për aplikim

1. Aplikuesit mund të jenë fermerë, grup fermerësh, persona fizikë ose juridikë, shoqëri të bashkëpunimit bujqësor (SHBB), organizatat e peshkimit (OP).

2. Fermerët, duhet të jenë të pajisur me NIPT-in e fermerit.

3. SHBB-të, OP-të dhe personat fizikë dhe juridikë të jenë të pajisur me NIPT/NUIS.

4. Aplikuesi, me statusin fermer ose person fizik dhe juridik, që kryen aktivitet për prodhimin bujqësor dhe blegtoral, peshkim/akuakulturë, njësi agrikulturore, në momentin e aplikimit, duhet të plotësojë formularin e aplikimit në portalin *e-Albania*.



Neni 13 Aplikimi

1. Aplikimi për marrjen e “Certifikatës paraprake” apo të “Certifikatës” kryhet nëpërmjet portalit *e-Albania*.

2. Informacioni për mënyrën e aplikimit në portalin *e-Albania*, kriteret e nevojshme për përfitim, tarifat dhe mënyrën e procedimit deri në përfitimin e “Certifikatës paraprake” apo “Certifikatës” publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe në platformën *e-Albania*.

Neni 14 Dokumentacioni për përfitimin e “Certifikatës paraprake”

1. Me qëllim plotësimin e kriterëve të parashikuara në VKM-në nr. 22/2018, të ndryshuar, subjektet që aplikojnë për përfitimin e “Certifikatës paraprake” duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë në portalin *e-Albania* formularin e aplikimit për pajisjen me “Certifikatë paraprake për veprimtarinë pritëse të certifikuar si agroturizëm”, si dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

a) mandatpagesën për aplikim në shumën 2000 lekë;

b) lejen e zhvillimit me treguesit e zhvillimit, nënshkruar nga titullari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në të cilën të jenë të parashikuara ferma bujqësore/blegtorale/peshkimit/akuakulturës /njësia agrokulturore, akomodimi, ushqimi dhe pijet, dokument ky i lëshuar nga organet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe/ose dokumentet nga bashkia që lejon ndërtimin e strukturës/objektit në funksion të agroturizmit, me planin e vendosjes, si dhe fragmenti i hartës kadastrale dhe kartela e pasurisë së paluajtshme, të njëjta në aplikimin për marrjen e lejes zhvillimore, pranë organeve përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;

c) projekti, për të gjithë strukturën e agroturizmit që do të ndërtohet, ku të jetë e përfshirë ferma bujqësore/blegtorale/peshkim/akuakulturë ose njësia agrokulturore, akomodimi, ushqimi dhe pijet, i nënshkruar nga inxhinieri/studioja inxhinierike, dokument ky i njëjtë në aplikimin për marrjen e lejes zhvillimore, pranë organeve përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Neni 15 Dokumentacioni për përfitimin e “Certifikatës”

1. Me qëllim plotësimin e kriterëve të parashikuara në VKM-në nr. 22/2018, të ndryshuar, subjektet që aplikojnë për përfitimin e “Certifikatës” duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë në portalin *e-Albania* formularin e aplikimit për pajisjen me “Certifikatë, subjekt i certifikuar për veprimtarinë e agroturizmit”, si dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

1.1 Dokumentet e nevojshme që duhet të plotësojë subjekti, në lidhje me shërbimin e akomodimit:

a) Certifikatë kategorizimi si strukturë akomoduese;

1.2 Dokumentet e nevojshme që duhet të plotësojë subjekti në lidhje me strukturën akomoduese, ushqim dhe pije (nëse nuk ka certifikatë kategorizimi) dhe fermën bujqësore/blegtorale/peshkimit/akuakulturës apo njësinë agrokulturore, janë:

a) fragment i hartës kadastrale dhe kartela e pasurisë së paluajtshme ose akti i marrjes së tokës në pronësi për fermën/tokën ku zhvillohet veprimtaria që do të certifikohet ose kontrata për marrjen e saj me qira, ose kontrata e përdorimit ose vërtetim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës në rastin kur ferma, struktura akomoduese, shërbimi i ushqimit dhe pijeve ndodhet në zonat e pamenaxhuara, ose certifikatë e përdorimit të ndërtimit lëshuar nga njësia e qeverisjes vendore, në rastet kur objekti nuk është pajisur me dokumentacionin e pronësisë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Në rast se subjekti zotëron fermën bujqësore, duhet të ketë të paktën 1 (një) ha tokë në pronësi ose përdorim të mbjellë me kultura bujqësore dhe subjekti duhet të ketë edhe një ambient për përpunimin e produkteve bujqësore;

b) në rast se subjekti ushtron veprimtarinë e akuakulturës, duhet të depozitojë lejen e përdorimit ose lejen e ushtrimit të aktivitetit të peshkimit në ujëmbledhëse dhe genplanin e sipërfaqes ujore jo më të vogël se 3000 (tre mijë) metër katrorë;

c) mandatpagesën për aplikim në shumën 2 000 lekë;

ç) fotografi të fermës bujqësore/blegtorale/peshkimit/akuakulturës/njësisë agrokulturore dhe të strukturës akomoduese dhe të restorantit;



d) vetëdeklarimin në portalin *e-Albania* që mban përgjegjësi që minimalisht 30% e produkteve ushqimore dhe të pijeve të jenë me origjinë nga ferma, jo më pak se 40% të sasisë së tyre, me origjinë lokale, brenda territorit të bashkisë ku ushtrohet veprimtaria e agroturizmit dhe jo më shumë se 30% e sasisë së tyre me origjinë tjetër;

dh) planimetri të strukturës akomoduese dhe ushqimit, dhe pijeve;

1.3 Dokumentet e nevojshme që duhet të plotësojë subjekti për shërbimin “veprimtari argëtuese/edukative, të lidhura me fermën ose mjedisin përreth”:

a) subjekti duhet të plotësojë në portalin *e-Albania* llojin e veprimtarisë që do të ofrojë, ku të paraqiten itineraret me shpjegimet përkatëse për çdo aktivitet.

2. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit siguron, nëpërmjet portalit *e-Albania*, dokumentacionin si vijon:

a) në rast se subjekti nuk është pajisur me certifikatë kategorizimi:

i. vërtetim që struktura plotëson kushtet për masat mbrojtëse nga zjarri, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri;

ii. vërtetim që struktura plotëson kushtet higjieno-sanitare, lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik;

iii. vërtetim për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit si person fizik/juridik me objekt veprimtarie si strukturë akomoduese;

iv. vërtetim i gjendjes gjyqësore të pronarit/administratorit;

b) në rast se subjekti zotëron fermën blegtorale, sekretariati teknik i Komisionit siguron vërtetimin e regjistrimit të fermës nga sistemi i informacionit blegtoral dhe veterinar “RUDA” dhe numrat e matrikujve për kafshët që identifikohen individualisht të lëshuar nga shërbimi veterinar rajonal, të cilat të jenë lëshuar brenda 3 (tre) muajve të fundit nga momenti që subjekti bën aplikimin në portalin *e-Albania*;

c) në rast se subjekti ushtron aktivitetin e bletërritjes për prodhimin e mjaltit, produkteve dhe nënprodukteve të tjera, sekretariati teknik i Komisionit siguron vërtetimin e regjistrimit të fermës sipas sistemit të informacionit veterinar dhe blegtoral RUDA, dhe matrikujt për çdo koshere, të lëshuar nga shërbimi veterinar rajonal. Subjekti duhet të ketë parkun e bletëve me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) zgjoje. Në këtë rast, subjekti duhet të ketë në pronësi ose përdorim një ambient për

vendosjen e bletëve, si dhe për mbledhjen e prodhimin e nënprodukteve të mjaltit.

Neni 16

Vlerësimi dhe pajisja me certifikatë

1. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë-punëve nga depozitimi i aplikimit në portalin *e-Albania* ose nga data e ngarkimit të dokumentacionit të plotë në portalin *e-Albania*, Komisioni merr në shqyrtim dosjen e aplikantit dhe nënshkruan procesverbalin e vlerësimit për marrjen ose jo të certifikatës.

2. Procesverbali hartohet nga sekretariati teknik dhe nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.

3. Vendimi për pranimin ose refuzimin e aplikimit për pajisjen me certifikatë paraprahe apo certifikatë bëhet mbi bazën e dokumenteve të ngarkuara në portalin *e-Albania* edhe rast pas rasti kur gjykohet e nevojshme nga verifikimi në terren.

4. Mungesa e njërit prej dokumenteve të kërkuara, pas plotësimit të afatit kohor të specifikuar në pikën 3, të nenit 7, të kësaj rregulloreje, çon në refuzimin e aplikimit.

5. Njoftimi i subjektit për tërheqjen e “Certifikatës paraprahe” ose “Certifikatës” apo refuzimi i kërkesës për pajisje me certifikatë bëhet nëpërmjet portalit *e-Albania*, brenda 5 (pesë) ditë-punëve nga data e lëshimit të certifikatës apo e vendimit përfundimtar të refuzimit.

6. Marrja/tërheqja e “Certifikatës paraprahe” ose e “Certifikatës” bëhet pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin, nga vetë aplikuesi.

7. Në rastet kur subjektet që aplikojnë për përfitimin e “Certifikatës”, kanë paraqitur dokumentacionin sipas shkronjës “a”, pika 1.2 dhe pika 2, neni 15, të kësaj rregulloreje, sekretariati teknik bashkërendon procesin me Komisionin e Standardizimit të Veprimtarive Turistike, me qëllim pajisjen e subjektit me certifikatën e kategorizimit.

Neni 17

Modeli i “Certifikatës paraprahe” apo i “Certifikatës”

1. Certifikata e ushtrimit të veprimtarisë së agroturizmit përmban:

a) emërtesën e subjektit;

b) kategorinë;

c) datën e lëshimit të certifikatës;

d) datën e përfundimit të afatit të certifikatës;



dh) nënshkrimin e ministrit ose personi i autorizuar prej tij.

2. “Certifikata paraprake” apo “Certifikata” gjenerohet *online* në sistemin *e-Albania*.

3. “Certifikata paraprake” apo “Certifikata” është sipas formatit dhe modelit, shtojca 2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe afishohet në reception/zonën e pritjes së strukturës së agroturizmit.

4. “Certifikata paraprake” apo “Certifikata” regjistrohet në Regjistrin Qendror të Turizmit, i administruar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Neni 18 Pezullimi

1. Komisioni pezullon “Certifikatën paraprake” apo “Certifikatën” kur konstaton, kryesisht nga verifikimet e kryera prej tij apo nga organet përkatëse të bashkive, të Inspektoratit të Turizmit, organet tatimore apo organet kompetente të inspektimit të ushqimit dhe kushteve higjieno-sanitare, ndryshim, mospërmbushje ose shkelje të një ose disa kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në VKM-në nr. 22/2018, të ndryshuar, dhe në këtë rregullore.

2. Komisioni, brenda 5 (pesë) ditë-punëve nga dita e konstatimit të ndryshimit, mospërmbushjes apo shkeljes së një ose disa kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në VKM-në nr. 22/2018, të ndryshuar, dhe në këtë rregullore, njofton subjektin mbi fillimin e procedurës së pezullimit të “Certifikatës paraprake” apo “Certifikatës”. Subjekti, brenda 10 (dhjetë) ditë-punëve, paraqet pranë Komisionit argumente/prova/dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e kriterëve dhe/ose kushteve përkatëse.

3. Mosplotësimi i kriterëve/kushteve, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, përbën shkak për shfuqizimin e “Certifikatës paraprake” apo sipas rastit të “Certifikatës”.

4. Subjekti të cilit i pezullohet “Certifikata paraprake” apo “Certifikata” nuk mund ta përdorë atë në ambientet e tij ose në emërtimin tregtar.

5. Vendimi i Komisionit për pezullimin e “Certifikatës paraprake” apo, sipas rastit, të “Certifikatës”, duhet të jetë i arsyetuar.

6. Në rast se shkaqet e pezullimit kanë rënë, Komisioni njofton pa vonesë subjektin.

7. Kundër vendimit të Komisionit për pezullimin e “Certifikatës paraprake” apo, sipas rastit, të

“Certifikatës”, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 19 Shfuqizimi

1. Komisioni nga verifikimet e kryera nga ana e tij, kryesisht apo nga shkeljet e konstatuara nga organet përkatëse, pasi të ketë përmbushur procedurën që garanton të drejtën për t’u informuar, për të kërkuar sqarime rreth fakteve dhe për t’u dëgjuar, mund të shfuqizojë “Certifikatën paraprake” apo “Certifikatën”, në rastin kur:

a) konstatohen të dhëna të rreme në dokumentet e aplikimit në platformën *e-Albania* për përfitimin e “Certifikatës paraprake” apo “Certifikatës”;

b) nuk përmbushen brenda afatit shkaqet e pezullimit sipas përcaktimit të nenit 18;

c) subjekti shkel në mënyrë të përsëritur një ose disa prej kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në VKM-në nr. 22/2018, të ndryshuar, dhe në këtë rregullore.

2. Shfuqizimi i “Certifikatës paraprake” ose i “Certifikatës” detyron subjektin të kthejë lehtësirat fiskale të përfituara, sipas parashikimit në pikën 18/1, në VKM-në nr. 22/2018, të ndryshuar.

3. Komisioni, brenda 5 (pesë) ditë-punëve nga marrja e vendimit, i propozon ministrit përgjegjës për turizmin nxjerrjen e aktit të shfuqizimit të “Certifikatës paraprake” apo “Certifikatës”.

4. Sekretariati teknik, brenda 3 (tri) ditë-punëve nga nxjerrja e aktit, sipas pikës 2 të këtij neni, njofton subjektin.

5. Ndaj vendimit për shfuqizimin e “Certifikatës paraprake” apo “Certifikatës”, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 20 Procesi i monitorimit

1. Monitorimi i të gjithë përfituesve të “Certifikatës paraprake” apo “Certifikatës” bëhet nga ana e organeve përkatëse të bashkive, Inspektoratit të Turizmit ose organeve kompetente të inspektimit të ushqimit dhe të kushteve higjieno-sanitare, agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor, agjencive të shërbimit veteriner dhe mbrojtjes së bimëve, sipas fushës së përgjegjësisë dhe në përputhje me VKM-në nr. 22/2018, të ndryshuar.



2. Në rast konstatimi të shkeljeve, organet e përmendura në pikën 1 të këtij neni njoftojnë Komisionin, nëpërmjet sekretariatit teknik, duke i vënë në dispozicion kopje të firmosura dhe vulosura të akteve të inspektimit.

Neni 21 Vlefshmëria

1. Vlefshmëria e “Certifikatës paraprake” është për një periudhë 2-vjeçare (dyvjeçare). Në rastet kur subjektet nuk kanë përfunduar ndërtimin e strukturës sipas periudhës së përcaktuar, duhet të paraqesin, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e përfundimit të afatit, dokumentacionin si më poshtë:

- kërkesë me shkrim për shtyrjen e afatit;
- vendimin për shtyrje afati të lejes së ndërtimit ose lejen e ndërtimit, kur ajo ka një afat zbatimi për më shumë se 2 vite;

2. Sekretariati Teknik i vendos në dispozicion Komisionit kërkesat sipas afateve të përcaktuara.

3. Komisioni, pas shqyrtimit të kërkesës, njofton zyrtarisht subjektin për shtyrjen e afatit;

4. Në rast se subjektet nuk paraqesin kërkesën sipas përcaktimit në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 20 të këtij urdhri, sekretariati teknik i paraqet Komisionit listën e subjekteve të cilëve u ka përfunduar afati.

5. Komisioni vendos për fillimin e procedurës së shfuqizimit të certifikatës paraprake duke iu referuar nenit 19/1 dhe 21/1 të VKM-së nr. 22/2018, të ndryshuar. Sekretariati teknik njofton zyrtarisht subjektin për fillimin e procedurës, duke i lënë një

afat 14 (katërmëdhjetë) ditë-pune subjektit për të aplikuar për pajisjen me certifikatë apo shtyrjen e afatit të certifikatës paraprake.

6. Në rast se subjekti brenda 14 (katërmëdhjetë) ditë-punëve nuk aplikon për shtyrje të afatit të certifikatës paraprake apo pajisjen me certifikatë, Komisioni vendos për shfuqizimin e certifikatës paraprake.

7. Sekretariati teknik pas vendimit të Komisionit, njofton zyrtarisht njësinë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektin për shfuqizimin e certifikatës paraprake dhe detyrimin e subjektit për kthimin e lehtësirave fiskale të përfituara.

8. Pas plotësimit të afatit kohor të “Certifikatës paraprake” subjektet duhet të kryejnë aplikimin në platformën *e-Albania* për pajisjen me certifikatë.

9. Subjektet që zotërojnë “Certifikatë paraprake” mund të aplikojnë në platformën *e-Albania* për “Certifikatë” edhe para përfundimit të afatit 2-vjeçar.

Neni 22 Rinovimi i certifikatës

1. Në rast se subjekti nuk ka ndryshime në strukturën akomoduese, fermën bujqësore/blegtorale/peshkimit/ akuakulturës apo njësinë agrikulturore, në sistemin *e-Albania* do të ruhen automatikisht të dhënat e deklaruara nga subjekti në momentin e aplikimit.

2. Në rastet kur subjekti ka ndryshime të veprimtarisë së agroturizmit, do t'i deklarojë në platformën *e-Albania*, duke bashkëngjitur dokumentacionin që vërteton ndryshimet.

ANEKS 1

Formular vetëdeklarimi për aplikim për certifikimin e strukturave akomoduese në funksion të agroturizmit

Kategoria për të cilën aplikon:

- | | | |
|--|---------------------------------|---|
| ☐ Bujtinë | ☐ Hotel | ☐ Qendër kurative |
| ☐ Fjetinë (hostel); | ☐ Motel | ☐ Fjetje dhe mëngjes (B&B) |
| ☐ Kamping | ☐ Resort | |

Detajet e aktivitetit	NIPT-i	
	Emri i subjektit	
	Emri tregtar	
	Përfaqësuesi ligjor F ☐ M ☐	
	Forma e pronësisë	
	Vlera e investimit	
	Viti i operimit	
	Aktiviteti ushtrohet	☐ Gjithë vitin ☐ Sezonal
	Adresa e plotë e aktivitetit	



	(prefektura, bashkia, qyteti/fshati, lagja, rruga, nr.)		
	Vendndodhja gjeografike (GIS)		
Kapaciteti i strukturës	Kapaciteti akomodues në dhoma		
	Kapaciteti akomodues në shtretër		
	Kapaciteti në bar-kafe, vende ulje (persona)		
	Kapaciteti në restorante, vende ulje (persona)		
	Nr. i sallave për konferenca		
	Kapaciteti për sallë		
Mjete kontakti	E-mail		
	Telefon fiks		
	Mobile		
	Website		
Kategoritë e punësimit	Punonjës me kohë të plotë	Total	
		Femra	
		Meshkuj	
	Punonjës me kohë të pjesshme	Total	
		Femra	
		Meshkuj	
	Punonjës me kontratë	Total	
		Femra	
		Meshkuj	
	Të vetëpunësuar	Total	
		Femra	
		Meshkuj	
Kualifikimi i punonjësve	Me arsim të lartë		
	Me arsim të mesëm të përgjithshëm		
	Me arsim të mesëm profesional		
	Me certifikata/diploma ndërkombëtare		
	Me certifikatë kualifikimi etj.		
Informacione të tjera	Numri i kateve të strukturës akomoduese		
	Ashensor		
	Dhoma pa tualet personal		
	Tualete të përbashkëta		
	Vende parkimi		
	Pishinë	☐ e jashtme	
		☐ e brendshme	
	Mjedise të tjera argëtuese e sportive		
	Ofrim i vakteve të tjera		
	Ofrim i akomodimit për një kohë të shkurtër (më pak se një natë fjetje)		
	Pronari i strukturës fle në të njëjtën strukturë		



ANEKS 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT



CERTIFIKATË PARAPRAKE

SUBJEKT I CERTIFIKUAR PËR VEPRIMTARINË PRITËSE TË CERTIFIKUAR SI
AGROTURIZËM



Kjo certifikatë i lëshohet:

Subjektit me NIPT

Për klasifikimin si “Subjekt i certifikuar për veprimtarinë pritëse të certifikuar si agroturizëm”

Lëshuar mëE vlefshme deri më

MINISTËR/PERSONI AUTORIZUAR

.....



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT



CERTIFIKATË

SUBJEKT I CERTIFIKUAR PËR VEPRIMTARINË E AGROTURIZMIT



Kjo certifikatë i lëshohet:

Subjektit me NIPT

Për klasifikimin si “Subjekt i certifikuar për veprimtarinë e agroturizmit”

Lëshuar mëE vlefshme deri më

MINISTËR/PERSONI AUTORIZUAR

.....

**KËRKESË**

Shtetasja Eglantina Aliaj kërkon, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, shpalljen të vdekur të shtetasit Eduart Aliaj, i biri i Fatmir dhe Florije, i lindur më 21.3.1977, në Ballsh, Mallakastër, Fier, dhe caktimin e kerkueses si kujdestare për administrimin e pasurisë së tij.

KËRKUESE
Eglantina Aliaj

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë